



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Deklarimi i Pasurisë

Analizë e shkurtër krahasuese për deklarimin e pasurisë së
udhëheqësve të institucioneve kryesore publike në
vitin 2010 dhe 2011

TETOR 2011



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga National Endowment for Democracy - NED. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e NED.

Hyrje

Bazuar në Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, edhe këtë vit Agjencia Kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare, u ka kërkuar zyrtarëve të lartë publikë që të bëjnë deklarimin e pasurisë dhe gjithashtu ka publikuar në ueb-faqen e saj të gjitha deklarimet e pasurisë. Kjo është bërë përmes *Regjistrimit për deklarimin e pasurisë*. Ky regjistër përmban të njëjtat komponente sikur *Formulari për deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë*, i cili është përdorur vitin e kaluar për deklarimin e pasurisë, megjithatë regjistri i vitit 2011 është shumë më konciz dhe i lexueshëm, edhe për faktin se të gjitha deklarimet janë plotësuar në versionin elektronik.

Kjo analizë krahasuese politikash, e dyta e këtij lloji, synon të pasqyrojë vlerën totale monetare¹ të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë të deklaruar vitin e kaluar dhe sivjet, si dhe të tregojë trendet në këtë aspekt. Kjo e fundit bëhet duke i krahasuar shumat totale të pasurisë së deklaruar vitin e kaluar me ato të deklaruar sivjet, bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit në ueb-faqen e saj. Për qëllim të kësaj analize janë përzgjedhur udhëheqësit e institucioneve kryesore publike, përkatësisht:

1. Kryetari i Kuvendit dhe Presidentja e Republikës;
2. Anëtarët e Qeverisë (Kryeministri, Zëvendëskryeministrat dhe të gjithë Ministrat);
3. Udhëheqësit e institucioneve kryesore të pavarura dhe agjencive kryesore ekzekutive (të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Shtetit, Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Policisë së Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë);
4. Udhëheqësit e ndërmarrjeve më të mëdha publike (Korporatës Energjetike të Kosovës, Postës dhe Telekomit të Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës); dhe
5. Udhëheqësit e partive më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvend (Partisë së Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje!, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës², Aleancës Kosova e Re dhe Partisë së Pavarur Liberale [origj. *Samostalna Liberalna Stranka*]).

¹ Në këtë analizë në përlogaritjen e totalit të pasurisë së zyrtarëve nuk janë përfshirë shumat monetare të deklaruara si detyrime financiare ndaj institucioneve bankare, përkatësisht kreditë e zyrtarëve.

² Në mungesë të deklarimit nga Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj (për shkaqe të njohura), kemi analizuar deklarimin e pasurisë nga Nënkryetari i Parë i saj, Blerim Shala.

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

Diferencat në deklarinë e pasurisë në mes të vitit 2010 dhe 2011

Kuvendi dhe Presidenca e Republikës së Kosovës

Në vitin 2010, Kryetari i Kuvendit, **Jakup Krasniqi** (në po të njëjtin funksion publik), ka deklaruar pasuri në vlerë monetare prej gjithsej €976,880,00, kurse në vitin 2011 shuma e deklaruar është gjithsej €443,247, gjë që përbën vlerë më të vogël monetare për €533,633.00. Në vitin 2010,³ Presidentja e Republikës, **Atifete Jahjaga**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Zëvendësës së Parë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës) ka deklaruar pasuri në vlerë monetare prej gjithsej €25,084, kurse vlera e deklaruar sivjet është gjithsej €54,945,52, që i bie €29,861 më e lartë.⁴

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në vitin 2010, Kryeministri dhe Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, **Hashim Thaçi** (në po të njëjtin funksion publik, atë të shefit të ekzekutivit), ka deklaruar pasuri në vlerë monetare prej gjithsej €888,8827.00, kurse në vitin 2011 shuma e deklaruar është gjithsej €786,742.00 gjë që paraqet vlerë më të vogël monetare për €102,085.00.⁵ Në anën tjetër, deklarimi i pasurisë i vitit 2010 nga ana e Zëvendëskryeministrit të Parë dhe Kryetarit të Aleancës Kosova e Re, **Behxhet Pacolli** (atëherë në funksionin publik të deputetit të Kuvendit), nuk është publikuar, ndërsa këtë vit ai ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej €171,829,448.93.⁶ Zëvendëskryeministri tjetër, njëkohësisht Ministër i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Zëvendëskryeministrit) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €458,436.00 ndërsa totali i vlerës së pasurisë së deklaruar këtë vit është €448,672.00, përkatësisht €9,764.00 më e ulët.⁷

³Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Jakup_Krasniqi%20Kryetar%20i%20Kuvendit.pdf)

[ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Jakup_Krasniqi%20Kryetar%20i%20Kuvendit.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Jakup_Krasniqi%20Kryetar%20i%20Kuvendit.pdf)

Deklarimi për 2011: http://www.akk-ks.org/2011/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Jakup_Krasniqi.pdf

⁴ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Policia_e_Kosoves/2010_Atifete%20Jahjaga%20-%20Zevendes%20Drejtor.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Policia_e_Kosoves/2010_Atifete%20Jahjaga%20-%20Zevendes%20Drejtor.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Policia_e_Kosoves/2010_Atifete%20Jahjaga%20-%20Zevendes%20Drejtor.pdf);

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Presidenca_e_Republikes_se_Kosoves/Atifete_Jahjaga.pdf

⁵ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hashim%20Thaci-Kreminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hashim%20Thaci-Kreminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hashim%20Thaci-Kreminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf);

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf).

⁶ Deklarimi për 2010: Kuvendi i Kosovës - Deputetët:

<http://www.akk-ks.org/?cid=1,1010>;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf).

⁷ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hajredin%20Kuci-zv.Kryeminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hajredin%20Kuci-zv.Kryeminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kreministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hajredin%20Kuci-zv.Kryeminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf);

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hajredin_Kuci.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hajredin_Kuci.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hajredin_Kuci.pdf).

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

Zëvendëskryeministrja, njëkohësisht Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, **Mimoza Kusari-Lila** në vitin 2010 nuk ka ushtruar asnjë post/detyrë zyrtare dhe për këtë nuk ka pasur obligim të deklarojë pasurinë. Vlera e pasurisë që ajo ka deklaruar në vitin 2011 është gjithsej €320,860.00⁸ Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, njëherësh Kryetar i Parisë së Pavarur Liberale (origj. *Samostalna Liberalna Stranka*), **Slobodan Petrović**, vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit dhe atë të Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €173,520.00, kurse vlera e pasurisë së deklaruar këtë vit është gjithsej €150,000.00, respektivisht €23,520.00 më e ulët.⁹ Në anën tjetër, sipas deklarimeve të publikuara, vlera monetare e pasurisë së deklaruar vitin e kaluar nga ana e Zëvendëskryeministres **Edita Tahiri** (në funksion publik të deputetes së Kuvendit) është gjithsej €557,116.00, kurse vlera e pasurisë së deklaruar këtë vit është gjithsej €557,275.00, gjë që përbën vlerë më të madhe prej €159.¹⁰ Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi** vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit të Kuvendit dhe atë të Ministrit të Shëndetësisë) ka deklaruar pasuri në vlerë monetare prej gjithsej €748,200.00, kurse këtë vit kjo vlerë arrin gjithsej €752,200, respektivisht €3,800 më e lartë.¹¹

Më tej, Ministri i Punëve të Jashtme, **Enver Hoxhaj**, vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit të Kuvendit dhe atë të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €321,877.00, ndërsa vlera totale e pasurisë së deklaruar nga ana e tij këtë vit është €309,803.42 gjë që paraqet vlerë më të ulët për €12,073.58.¹² Të njëjtin lloj trendi tregon edhe krahasimi i deklarimeve të pasurisë nga ana e Ministres së Integrimit Evropian, **Vlora Çitaku**: vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetes së Kuvendit dhe Zëvendësministres së Punëve të Jashtme) ajo ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €182,120.00, kurse totali i vlerës së deklaruar nga ana e saj këtë vit është €166,740.00, vlerë kjo më e ulët për €15,380.00.¹³ Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, **Agim Çeku**, vitin e kaluar nuk ka

⁸ Deklarimi për 2010: Kuvendi i Kosovës - Deputetët:

<http://www.akk-ks.org/?cid=1,1010>;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Mimoza_Kusari.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Mimoza_Kusari.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Mimoza_Kusari.pdf).

⁹ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Slobodan%20Petrovic%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Slobodan_Petrovic.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Slobodan_Petrovic.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Slobodan_Petrovic.pdf).

¹⁰ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Edit%20Tahiri%20-%20Deputete.pdf;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Edita_Tahiri.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Edita_Tahiri.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Edita_Tahiri.pdf).

¹¹ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Bujar%20Bukoshi%20-%20Deputet.pdf

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Bujar_Bukoshi.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Bujar_Bukoshi.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Bujar_Bukoshi.pdf).

¹² Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Enver%20Hoxhaj%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Jashtme/Enver_Hoxhaj.pdf.

¹³ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Vlora%20Citaku%20-%20Deputete.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Integrimit_Evropian/Vlora_Citaku.pdf.

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

deklaruar pasurinë, pasi që nuk ka ushtruar ndonjë funksion publik, kurse vlera monetare e pasurisë së deklaruar nga ana e tij këtë vit është gjithsej €647,548.00.¹⁴

Ministri i Punëve të Brendshme, **Bajram Rexhepi**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €410,900.00, kurse këtë vit ajo arrin vlerën prej €339,600.00, pra €71,300.00 më e ulët.¹⁵ Ministri i Financave, **Bedri Hamza**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Zëvendësministrit të Ekonomisë dhe Financave) ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €262,464.00, kurse këtë vit kjo vlerë është gjithsej €222,281.00, pra €40,184 më e ulët.¹⁶ Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, **Memli Krasniqi**, vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit dhe këshilltarit të Kryeministrit/Zëdhënësit të Qeverisë) ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €125,256.00, kurse vlera e deklaruar këtë vit është €130,180.00, ose €4,924 më e lartë.¹⁷

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, **Besim Beqaj**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Ministrit të Integrimit Evropian) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €2,374,780.00, kurse këtë vit totali i kësaj vlere është €901,680.00, përkatësisht €1,473,100.00 më i ulët.¹⁸ Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Ramë Buja**, vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit të Kuvendit) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €316,818.00 kurse këtë vit kjo vlerë ka arritur në €326,960.00, që tregon një rritje prej €10,142.00.¹⁹ Ministri i Administratës Publike, **Mahir Yağcılar**, vitin e kaluar (në funksionin publik të deputetit të Kuvendit dhe atë të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €272,688.00, ndërsa totali i vlerës së deklaruar sivjet është €258,960.00, gjë që përbën një vlerë për €13,728.00 më të ulët.²⁰

¹⁴ Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves/Agim_Ceku.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves/Agim_Ceku.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves/Agim_Ceku.pdf).

¹⁵ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Zyrtaret_e_Larte_%20ne_MPB/2010_Bajram_Rexhepi-Minister-Ministria_e_punve_te_brendshme.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Zyrtaret_e_Larte_%20ne_MPB/2010_Bajram_Rexhepi-Minister-Ministria_e_punve_te_brendshme.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshem/Zyrtaret_e_Larte_%20ne_MPB/2010_Bajram_Rexhepi-Minister-Ministria_e_punve_te_brendshme.pdf);

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshme/Bajram_Rexhepi.pdf.

¹⁶ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave/Zyrtaret_e_Larte_me_MEF/2010_Bedri%20Hamza%20-%20z.v%20Minister.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave/Zyrtaret_e_Larte_me_MEF/2010_Bedri%20Hamza%20-%20z.v%20Minister.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave/Zyrtaret_e_Larte_me_MEF/2010_Bedri%20Hamza%20-%20z.v%20Minister.pdf);

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Financave_(Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave)/Bedri_Hamza.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Financave_\(Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave\)/Bedri_Hamza.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Financave_(Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave)/Bedri_Hamza.pdf).

¹⁷

Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Memli%20Krasniqi%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministri_e_Kultures_Rinise_dhe_Sportit/Memli_Krasniqi.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministri_e_Kultures_Rinise_dhe_Sportit/Memli_Krasniqi.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministri_e_Kultures_Rinise_dhe_Sportit/Memli_Krasniqi.pdf).

¹⁸ Deklarimi për 2010:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_per_Integrime_Evropiane/Zyrtare_%20e_Larte_ne_MIE/2010_Besim_Beqaj-Minister_ministria_per_integrime_evropiane.pdf)

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_per_Integrime_Evropiane/Zyrtare_%20e_Larte_ne_MIE/2010_Besim_Beqaj-Minister_ministria_per_integrime_evropiane.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_per_Integrime_Evropiane/Zyrtare_%20e_Larte_ne_MIE/2010_Besim_Beqaj-Minister_ministria_per_integrime_evropiane.pdf);

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Zhvillimit_Ekonomik/Besim_Beqaj.pdf.

¹⁹ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Rame%20Buja%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Arsimit_Shkences_dhe_Teknologjise/Rame_Buja.pdf)

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Arsimit_Shkences_dhe_Teknologjise/Rame_Buja.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Arsimit_Shkences_dhe_Teknologjise/Rame_Buja.pdf).

²⁰ Deklarimi për 2010:

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

Ministri i Infrastrukturës, **Fehmi Mujota**, në vitin 2010 (në funksionin publik të deputetit të Kuvendit dhe atë të Ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €235,428, kurse në deklarinë e sivjetshëm kjo vlerë ka arritur në €292,741.00, pra €57,313.00 më e lartë.²¹ Edhe deklarimi i Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Blerand Stavileci**, tregon një trend të tillë: vlera totale monetare e pasurisë së deklaruar nga ana e tij vjet është €183,907.00 ndërsa në deklarinë e sivjetshëm kjo vlerë ka arritur në €221,989.00, respektivisht €38,082.00 më e lartë.²² Ministri i Shëndetësisë, **Ferid Agani**, vitin e kaluar nuk e ka deklaruar pasurinë e tij, pasi që nuk ka ushtruar ndonjë funksion publik, kurse vlera totale monetare e pasurisë së deklaruar nga ana e tij sivjet është €318,461.00.²³

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Nenad Rašić**, vitin e kaluar (në po të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €642,540.00, ndërsa kjo vlerë këtë vit ka arritur në €823,700.00, respektivisht €181,160 më e lartë.²⁴ Sa i përket Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **Dardan Gashi**, ndonëse vitin e kaluar ka ushtruar funksion publik, atë të Zëvendësministrit të Integritimit Evropian, në ueb e AKK-së nuk figuron deklarimi i pasurisë nga ana e tij, kurse këtë vit ai ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €1,191,400.00.²⁵ Në fund, Ministri i Komuniteteve dhe Kthimit, **Radojica Tomić**, vitin e kaluar nuk ka deklaruar pasurinë e tij, pasi që nuk ka ushtruar ndonjë funksion publik, kurse vlera totale e pasurisë së deklaruar sivjet nga ana e tij është €10,000.²⁶

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Mahir%20Jagcilar%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Administrates_Publike/Mahir_Yagcilar.pdf.

²¹ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Fehmi%20Mujota%20-%20Deputet.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Transportit_dhe_Poste-Telekomunikacionit/Fehmi_Mujota.pdf.

²² Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Bugesise_Pylltarise_dhe_Zhvillimit_Rural/Zyrtaret_e_Larte_n_e_MBPZHR/2010_Blerand%20Stavileci%20Minister.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Bujqesise_Pylltarise_dhe_Zhvillimit_Rural/Blerand_Stavileci.pdf.

²³ Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Shendetesise/Ferid_Agani.pdf.

²⁴ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Punes_dhe_Mireqenies_Sociale/Zyrtaret_e_larte_ne_MPMS/2010_Nenad%20Rasic-%20Minister.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Punes_dhe_Mireqenies_Sociale/Nenad_Rasic.pdf.

²⁵ Deklarimi për 2010 - Ministria e Integritimit Evropian:

<http://www.akk-ks.org/?cid=1,1164>,

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Mjedisit_dhe_Planifikimit_Hapsinor/Dardan_Gashi.pdf.

²⁶ Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_per_Komunitete_dhe_Kthim/Radoica_Tomic.pdf.

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

Institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, **Enver Hasani**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €127,417.00, ndërsa vlera totale e pasurisë së deklaruar nga ana e tij sivjet është €133,060.00, respektivisht €5643 më e lartë.²⁷ Sipas të dhënave të publikuara në ueb-faqen e AKK-së, nuk figuron asnjë deklaram nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, **Enver Peci**.²⁸ Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, **Ismet Kabashi**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Kryeprokurorit të Shtetit) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €98,792.00, kurse këtë vit ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €133,458.45 përkatësisht €34,666.05 më shumë.²⁹

Vlera totale monetare e pasurisë së deklaruar nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, **Gani Gërguri**, në vitin 2010 (në funksionin publik të Zëvendësguvernatorit të BQK-së) është €280,640.00, kurse këtë vit kjo vlerë ka arritur në €312,513, respektivisht një rritje prej €31,890.10.³⁰ Sipas të dhënave të botuara në ueb-faqen e AKK-së, vetë kjo agjenci, pra as Drejtori i saj, **Hasan Preteni**, nuk figuron në listën e institucioneve të pavarura zyrtarët e lartë të cilëve kanë deklaruar pasuritë e tyre në vitin 2010, kurse shuma totale e pasurisë së deklaruar këtë vit nga Drejtori Preteni është €94,948.00³¹ As deklarimi i pasurisë për vitin 2010 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, **Reshat Maliqi**, nuk figuron në ueb-faqen e AKK-së, kurse vlera totale monetare e pasurisë së deklaruar nga ai këtë vit është €125,264.60.³²

Komandanti i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, **Sylejman Selimi**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €178,840.00, ndërsa kjo vlerë këtë vit ka arritur në €271,220.00, pra €92,380.00 më e lartë.³³ Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, **Naim Huruglica**, vitin e kaluar (në

²⁷ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Gjykatat_e_Kosoves/Gjykata_Kushtetuese_e_Kosoves/2010_Enver%20Hasani%20-%20Kryetar%20i%20Gjykes%20Kushtetuese.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Gjykatat_e_Republikes_se_Kosoves/Gjykata_Kushtetuese_e_Kosoves/Enver_Hasani.pdf.

²⁸ Deklarimi për 2010 - Këshilli Gjyqësor i Kosovës: [link](#); Deklarimi për 2011 - Këshilli Gjyqësor i Kosovës:

<http://www.akk->

[ks.org/?cid=1,1178&path=Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Keshilli_Gjyqesor_i_Kosoves](http://www.akk-ks.org/?cid=1,1178&path=Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Keshilli_Gjyqesor_i_Kosoves)

²⁹ Deklarimi për 2010:

<http://www.akk->

[ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Drejtises/Prokuroret_ne_Prokurorit_e_Kosoves/2010_Ismet_Kabashi-Kryeprokuror%20i%20Shtetit.pdf](http://www.akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Drejtises/Prokuroret_ne_Prokurorit_e_Kosoves/2010_Ismet_Kabashi-Kryeprokuror%20i%20Shtetit.pdf);

Deklarimi për 2011:

<http://www.akk->

[ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Drejtises/Prokuroret_ne_Republiken_e_Kosoves/Ismet_Kabashi.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Drejtises/Prokuroret_ne_Republiken_e_Kosoves/Ismet_Kabashi.pdf).

³⁰ Deklarimi për 2010: http://www.akk-ks.org/2010/Institucionet_e_Pavarura/Banka_Qendrore_e_Kosoves/2010_Gani%20Gerguri%20-%20Zv.Guvernator.pdf;

Deklarimi për 2011:

<http://www.akk->

[ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Banka_Qendrore_e_Kosoves/Gani_Gerguri.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Banka_Qendrore_e_Kosoves/Gani_Gerguri.pdf).

³¹ Deklarimi për 2010 - Institucionet e pavarura tw Republikws sw Kosovws:

<http://www.akk-ks.org/?cid=1,1096>;

Deklarimi për 2011:

<http://www.akk->

[ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Agjencia_Kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Agjencia_Kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf).

³² Deklarimi për 2010:

<http://www.akk-ks.org/?cid=1,996,4846> (nuk mund të shkarkohet);

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Puneve_te_Brendshme/Reshat_Maliqi.pdf.

³³ Deklarimi për 2010:

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

po të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri më vlerë prej gjithsej €131,500.00, kurse këtë vit kjo vlerë është €126,696.00, ose €4,804.00 më e lartë.³⁴ Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, **Bashkim Smaka**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €349,546.00, ndërsa këtë vit kjo vlerë ka arritur në gjithsej €357,640.00, pra €8,094 më e lartë.³⁵

Ndërmarrjet publike

Drejtori Menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës, **Arben Gjuka**, vitin e kaluar (në po të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €108,982.00, ndërsa këtë vit ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €111,373.00, e cila është €2,391 më e lartë.³⁶ Drejtori i Përgjithshëm i Postës dhe Telekomit të Kosovës, **Shyqyri Haxha**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) ka deklaruar pasuri me vlerë monetare prej gjithsej €103,136.00, ndërsa kjo vlerë këtë vit ka arritur në €116,866.51, gjë që paraqet një rritje prej €13,730.51.³⁷ Vlera monetare e pasurisë së deklaruar nga Drejtori Menaxhues i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, **Agron Mustafa**, vitin e kaluar (në të njëjtin funksion publik) është gjithsej €662,768.00, ndërsa kjo vlerë këtë vit ka arritur në €720,400.00, pra €57,632.00 më e lartë.³⁸

http://www.akk-ks.org/2010/Queveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Forces_se_Sigurise/Zyrtaret_e_Larte_ne_MFSK/2010_Sylejman%20Selimi-Komandant%20i%20FSK-se.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Queveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Forces_se_Sigurise_se_Kosoves/Sylejman_Selimi.pdf.

³⁴ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Queveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave/Doganat_e_Kosoves/2010_Naim%20Huruglica%20-%20Drejtore%20i%20Pergjithshem%20i%20Doganave%20te%20Kosoves.pdf;

Deklarimi për 2011:

[http://www.akk-ks.org/2011/Queveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Financave_\(Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave\)/Naim_Huruglica.pdf](http://www.akk-ks.org/2011/Queveria_e_Republikes_se_Kosoves/Ministria_e_Financave_(Ministria_e_Ekonomise_dhe_Financave)/Naim_Huruglica.pdf).

³⁵ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Institucionet_e_Pavarura/Agjencia_e_Kosoves_per_Intelegjence/2010_Bashkim%20Smakaj%20-%20Drejtore.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Agjencia_e_Intelegjences_se_Kosoves/Bashkim_Smakaj.pdf.

³⁶ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Ndermarjet_Publike/Korporata_Energjetike_e_Kosoves/2010_Arben%20Gjukaj-Drejtore%20Menagjues%20i%20KEK-ut.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Ndermarjet_Publike_te_Republikes_se_Kosoves/Korporata_Elektroenergjetike_e_Kosoves/Arben_Gjuka.pdf.

³⁷ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Ndermarjet_Publike/Posta_dhe_Telekomunikacioni_i_Kosoves/2010_Shyqyri%20Haxha%20-%20Kryeshef%20Ekzekutiv.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Ndermarjet_Publike_te_Republikes_se_Kosoves/Posta_dhe_Telekomunikacioni_i_Kosoves_Sh.A/Shyqyri_Haxha.pdf.

³⁸ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Ndermarjet_Publike/Aeroporti_Nderkombetar_i_Prishtines_Sh_A/2010_Agron%20Mustafa%20-%20Drejtore%20Menaxhues.pdf;

Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Ndermarjet_Publike_te_Republikes_se_Kosoves/Aeroporti_Nderkombetar_i_Prishtines/Agron_Mustafa.pdf.

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

Partitë kryesore politike parlamentare

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, **Isa Mustafa**, vitin e kaluar (në funksionin publik të Kryetarit të Komunës së Prishtinës) ka deklaruar pasuri me vlerë prej gjithsej €749,100.00, kurse këtë vit kjo vlerë është €790,460.00, respektivisht €41,360.00 më lartë.³⁹ Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje!, **Albin Kurti**, vitin e kaluar nuk ka deklaruar pasurinë e tij, pasi që nuk ka ushtruar ndonjë funksion publik, kurse vlera monetare e pasurisë së deklaruar nga ana e tij këtë vit është gjithsej €19,240.⁴⁰ As Nënkryetar i Parë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, **Blerim Shala**, nuk ka deklaruar pasurinë e tij vitin e kaluar, pasi që nuk ka ushtruar ndonjë funksion publik, kurse vlera e pasurisë së deklaruar nga ana e tij këtë vit është gjithsej €349,991.00.

Përmbledhje e gjetjeve - diferenca në vlerën e pasurisë së deklaruar AKK-së në vitin 2010 dhe 2011 nga ana e zyrtarëve të lartë të përzgjedhur për këtë studim politikash

³⁹ Deklarimi për 2010:

http://www.akk-ks.org/2010/Komunat_e_Republikes_se_Kosoves/Prishtine/2010_Isa%20Mustafa%20-%20Kryetar%20i%20Komunes.pdf; Deklarimi për 2011:

http://www.akk-ks.org/2011/Komunat_e_Kosoves/Komuna_Prishtine/Isa_Mustafa.pdf.

⁴⁰ Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje!, Albin Kurti, nuk ka ushtruar ndonjë post të zyrtarit të lartë gjatë vitit të kaluar. Deklarimi për 2011: http://www.akk-ks.org/2011/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Albin_Kurti.pdf.

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

2	Atifete Jahjaga	Presidente e Republikës së Kosovës	Pasuri e paluajtshme				
			Pasuri e luajtshme	Veturë	6,000.00 €	6,000.00 €	
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale				
			Posedimi i letrave me vlerë				
			Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara	1,900.00 €	7,849.00 €	
			Të hyrat vjetore të deklaruesit	Paga vjetore	12,504.00 €	34,478.40 €	
			Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es	Paga vjetore	4,680.00 €	6,618.12 €	
			Totali	25,084.00 €	54,945.52 €		
Vërejtje: Nuk vërehet ndryshim i madh në pasurinë e Presidentës veç se duhet të bëhet edhe zhvlerësimi i veturës.							
Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar		
					2010	2011	
Qeveria e Republikës së Kosovës							
3	Hashim Thaçi	Kryeministër	Pasuri e paluajtshme	Tokë (15.75 ari)	157,000.00 €	157,000.00 €	
				Shtëpi në Ndërtim (700 m2)	203,000.00 €	220,000.00 €	
				Tokë Bujqësore (7 hektarë)	180,000.00 €	180,000.00 €	
				Shtëpi (250 m2)	80,000.00 €	80,000.00 €	
			Pasuri e luajtshme	Veturë	11,000.00 €		
				Veturë Passat		13,000.00 €	
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale				
				Posedimi i letrave me vlerë			
				Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara	224,901.00 €	101,424.00 €
			Të hyrat vjetore të deklaruesit	Paga vjetore	17,318.00 €	17,318.00 €	
				Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es	Paga vjetore	15,608.00 €	18,000.00 €
			Totali	888,827.00 €	786,742.00 €		
Vërejtje: Në vitin 2010 dhe 2011 ka deklaruar të njëjtën kredi në vlerë prej 100,000.00€. Koha e pagesës është deklaruar të jetë 120 muaj. Për mjetet e deponuara nuk janë paraqitur burimet dhe							

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

sqarimet për përgjysmimin e tyre.						
Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar	
					2010	2011
Qeveria e Republikës së Kosovës						
4	Behxhet Pacolli	Zëvendëskryeministër i Parë dhe Kryetar i Aleancës Kosova e Re	Pasuri e paluajtshme	Kompani me aksione anonime, sipas ligjeve të shteteve ku ato veprojnë (jashtë Kosovës)		80,000,000.00 €
				Tokë, (29,345.00 m2) 2007		82,166.00 €
				Tokë, (13.32 m2) 2006		7,792.00 €
				Lokal Afarist, (248.57 m2) 2007		700,000.00 €
				Tokë, (1,64 Hektar) 2006		111,547.80 €
				Tokë, (4,39 hektar) 2006		223,752.30 €
				Tokë, (2.46 Hektar) 2006		73,797.00 €
				Tokë, (30,560.00), 2007		244,480.00 €
				Lokal Afarist nr.19, (65.02 m2) 2007		89,500.00 €
				Lokal Afarist nr.1, (583.94 m2)		900,000.00 €
				Tokë (0.29 Hektar)2004		126,000.00 €
				Tokë (0.18 Hektar) 2004		44,325.00 €
				Tokë (4.45 Hektar) 2006		336,378.25 €
				Tokë (5.43 Hektar) 2006		326,028.00 €
				Tokë (618,070.00 m2) 2006		6,665,417.00 €
				Shtëpi (5,200.00, m2) 2008		16,068,818.00 €
				Hotel Iliria (22,000.00 m2) 2008		24,650,000.00 €
				Hotel Grand Prishtina (38,000.00 m2)		3,300,000.00 €
			Pasuri e luajtshme	Mercedes Gl 450, 2008	100,000.00 €	

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

				Mercedes ML 500, 2006		60,000.00 €			
				Mercedes SL 600, 2006		50,000.00 €			
				Mercedes G55L,AMG, 2006		70,000.00 €			
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale	Banka Ekonomike në Kosovë (60 %) 2002		15,000,000.00 €			
				K.S. Siguria (Familja) (100 %) 2002		22,000,000.00 €			
			Posedimi i letrave me vlerë						
				Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara	27,786.92 €			
					Të deponuara	11,388.66 €			
				Të hyrat vjetore të deklaruesit	Qiraja vjetore (Siguria) BE	144,000.00 €			
					Paga Vjetore(ZKM) BE	16,272.00 €			
					Të Ardhura tjera(të deklaruar dhe të tatimuara në Zvicër) NLB	400,000.00 €			
			Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es						
			Totali					0.00 €	171,829,448.93 €
			Vërejtje: Nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2010.						
Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar				
					2010	2011			
Qeveria e Republikës së Kosovës									
5	Hajredin Kuçi	Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë	Pasuri e paluajtshme	Shtëpi (250 m2)	200,000.00 €	200,000.00 €			
				Shtëpi dhe tokë e përbashkët	200,000.00 €	200,000.00 €			
			Pasuri e luajtshme	Veturë	10,000.00 €	10,000.00 €			
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale						
			Posedimi i letrave me vlerë						

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

			Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara	16,000.00 €	8,000.00 €
				Paga vjetore (Qeveria)	14,196.00 €	14,196.00 €
			Të hyrat vjetore të deklaruesit	Honorar vjetor (Universiteti)	6,000.00 €	5,256.00 €
				Qiraja		6,000.00 €
				Paga vjetore nga Kuvendi	7,200.00 €	
			Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es	Paga vjetore	5,040.00 €	5,220.00 €
			Totali		458,436.00 €	448,672.00 €

Vërejtje: Në vitin 2010 ka deklaruar kredi në vlerë prej 39,900.00€, si dhe huamarrje në vlerë prej 10,000.00€. Po ashtu, gjatë vitit 2011 ka deklaruar kredinë e njëjtë 39,000.00€, ndërkaq huamarrje ka deklaruar shumën në vlerë prej 5,000.00.€ Gjithashtu ka të deklaruar të hyra vjetor qiranë nga banesa, mirëpo tek pasuria e paluajtshme nuk ka të deklaruar pasuri të tillë.

Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar	
					2010	2011
Qeveria e Republikës së Kosovës						
6	Mimoza Kusari Lila	Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Tregtisë dhe Industrisë	Pasuri e paluajtshme	Banesë 200 m2, 2008		200,000.00 €
				Shtëpi 100m2		70,000.00 €
			Pasuri e luajtshme			
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale			
			Posedimi i letrave me vlerë			
			Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara		4,000.00 €
				Të deponuara		1,500.00 €
			Të hyrat vjetore të deklaruesit	Shërbime konsulente		6,300.00 €
				Paga vjetore (Qeveria)		13,476.00 €
			Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es	Paga vjetore		25,584.00 €
Totali					0.00 €	320,860.00 €
Vërejtje: Deklaruesja në fjalë ka kredi në vlerë prej 30 000€ në TEB Bank për arsye të ndërtimit të banesës.						
Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar	

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

					2010	2011
Qeveria e Republikës së Kosovës						
7	Slobodan Petrovic	Zëvendëskryeministër, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Kryetar i Partisë së Pavarur Liberale	Pasuri e paluajtshme	Shtëpi 240m ² , 2009	120,000.00 €	120,000.00 €
				Tokë 6m ² , 2008	18,000.00 €	18,000.00 €
			Pasuri e luajtshme			
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale			
			Posedimi i letrave me vlerë			
			Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare			
			Të hyrat vjetore të deklaruesit	Posta	23,520.00 €	
				Kuvendi	12,000.00 €	
Qeveria		12,000.00 €				
Të hyrat vjetore të bashkëshortit/es						
Totali				173,520.00 €	150,000.00 €	
Vërejtje: Në vitin 2010 dhe 2011 në Raiffaisen Bank, ka deklaruar se ka kredi prej vitit 2009 deri ne 2012 nga e cila ka marr para të gatshme me vlerë monetare prej 15,000€. Në vitin 2010 në Pro Credite Bank, ka deklaruar se ka kredi prej vitit 2009 deri ne 2011 nga e cila ka marr para të gatshme me vlerë monetare prej 15,000€. Ndërsa në këtë vite ai ka deklaruar kredinë e njëjtë dy vjeçare me vlerë monetare prej 15,000€.						
Nr.			Kategoritë e deklarimit	Përshkrimi i pasurisë	Vlera e përgjithshme e deklaruar	
					2010	2011
Qeveria e Republikës së Kosovës						
8	Edita Tahiri	Zëvendëskryeministre	Pasuri e paluajtshme	Shtëpi 300 m2	300,000.00 €	300,000.00 €
				Tokë 1.5 Hektar	200,000.00 €	200,000.00 €
				Truall 2.5 Ari	5,000.00 €	5,000.00 €
			Pasuri e luajtshme			
				Veturë Astra	16,000.00 €	16,000.00 €
			Posedimi i aksioneve në shoqëri komerciale			
			Posedimi i letrave me vlerë			
Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare	Të deponuara	11,000.00 €	20,000.00 €			

Deklarimi i Pasurisë 2010-2011

				Të hyrat vjetore të deklaruesit	Paga vjetore nga Kuvendi Kosovës	15,516.00 €	
					Ijes Universum	9,600.00 €	
					Paga vjetore nga Qeveria e Kosovës		16,275.00 €
